



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POLIÇAN  
NJESIA E PROKURIMIT

Nr. \_\_\_ Prot

Data, \_\_. \_\_. 2024

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**Objekti i Procedurës:** *Blerje karburant naftë për nevojat e bashkise, kaldajave të shkollave dhe sektorit të mzsh-se*

**Kodi Përkatës**

**në Fjalorin e Përbashkët**

**të Prokurimit (CPV):** 09134000-7 naftë, Karburante- 09100000-0

**Vlera e Fondit Limit:** : 5 500 000 ( pesë milion e pesëqind mijë) leke pa tvsh

Burimi i financimit: nga buxheti i bashkise Polican i vitit 2024 ( transferte e pakushtezuar, të ardhurat e veta dhe nga transfertat specifike 2024 e detajuar : **916 666** (nëntëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë ) leke pa tvsh nga transfertat specifike e sektorit të mbrojtjes dhe shpëtimit nga zjarri dhe **4 583 334** (kater milion e pesëqind e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e kater ) leke pa tvsh **nga transfertat e pakushtezuar dhe të ardhurat e bashkise Polican për vitin 2024.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti kontraktor **Bashkia Polican** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:**

*a Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; I ZBATUESHEM*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26 dhe nenit 29, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

## **2. Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

2.1.1 Sipas percaktimeve te bera ne Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/ Kualifikimit).

Kjo pikë plotësohet me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8. Nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, në marrëveshjen e noterizuar, sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht, duhet të përcaktohen saktë përqindja e pjesëmarrjes së shërbimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi . Keto kritere vërtetojnë se operatorët ekonomikë kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi ose, në rastet e bashkimit të shoqërive, vërtetojnë se i gëzojnë këto aftësi në kohën e lidhjes së kontratës.

2.1.2 Subjekti duhet të jetë i pajisur me leje tregtimi, autorizim ose licencë per tregtim karburanti sipas legjislacionit ne fuqi ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar VKM-së nr. 970 datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” I ndryshuar .

Ky kriter konsiderohet i permbushur me paraqitjen e formularit te vetdeklarimit sipas shtojces 8. Shënim: Autoriteti Kontraktor do te beje verifikimin e dokumentacionit ne perputhje me vetedeklarimin e bere gjate fazes se ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit te dorezuar perben kusht s’kualifikimi. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të paraqesi dokumentacionin provues, original ose te noterizuar sipas deklaratës së mësipërme përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit , brenda afatit nga dërgimi i njoftimi për paraqitjen e tyre.

### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesi kopje të çertifikuar të bilancit, gjatë 3(tre) viteve fundit të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse (,2020,2021,2022),sipas ligjit nr. 10091 date 5.03.2009 ”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te rregjistruar dhe te kontabilistit te miratuar ” i ndryshuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk kanë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 ‘Për Tatimin Mbi të Ardhurat’ i ndryshuar

Vendosja e ketyre kriterëve behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine ekonomike dhe financiare te OE ofertues, duke vertetuar nepermjet dokumenteve te kerkuara me poshte, se zoterojne kapacitet ekonomike dhe financiare per te permbushur kontraten sic eshte parashikuar nga AK.

2.2.2. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2020 ,2021, dhe 2022**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës.

**Argumentimi:** Ky kriter, eshte vendosur ne perputhje me piken 3 te nenit 77 te Ligjit nr 162/2020, "Per Prokurimin Publik", ne te cilin gjejme te percaktuar se: *3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar;*

Si dhe ne nenin 43 te VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", si dhe nenin 55 te VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik" ku percaktohet se *4. Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm. Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.*

Vendosja e ketyre kritereve behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine ekonomike dhe financiare te OE ofertues, duke vertetuar nepermjet dokumenteve te kerkuara me poshte, se zoterojne kapacitet ekonomike dhe financiare per te permbushur kontraten sic eshte parashikuar nga AK.

**Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore** është bërë bazuar në nenin 43 pika 4 të VKM 285/2021 'Mbi Rregullat e Prokurimit Publik' ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;* si dhe nenit 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 'Për Tatimin Mbi të Ardhurat' i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave,

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

### **2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme :**

- a) Dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Realizimin me sukses i një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me institucione shtetërore, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe

të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos në përputhje me piken 4 te nenit 77 te Ligjit nr. 162/2020, "Per Prokurimin Publik" ,ne te cilin gjejme te percaktuar se: 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; si dhe me piken 4/b te nenit 55 të VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", ne te cilen eshte e percaktuar se: [...]Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat ethjeshtuara duhet të jetë:b) Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Vendosja e këtij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine teknike te OE ofertues, nepermjet pervojave te duhura, qe jane ne perpjesetim me natyren e objektit te prokurimit dhe qe ka aftesine e duhur per zbatimin e kontrates sic eshte parashikuar nga AK.

#### **Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe piken 4/b te nenit 55 të VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo me e vogel se 20 % të vlerës së fondit limit,që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Vendosja e këtij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine teknike te OE ofertues, nepermjet pervojave te duhura, qe jane ne perpjesetim me natyren e objektit te prokurimit dhe qe ka aftesine e duhur per zbatimin e kontrates sic eshte parashikuar nga AK.

2.3.2 Në përmbushje të nevojave të vazhdueshme dhe në mënyrë të leverdisshme financiarisht për Autoritetin Kontraktor ,operatori ekonomik duhet te disponoj minimumi një pikë karburanti te pakten në një distancë tokësore jo më larg se 23 km nga qyteti Polican (vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (akt pronësie ose kontrate noteriale qeraje,ose të pasqyruara në ekstraktin e rregjistrimit tregtar lëshuar nga QKB ose kontratë noteriale bashkepunimi apo furnizimi për gjithë kohëzgjatjen e kontrates ),

- Ky stacion te jenë i pajisura me Vertetim teknik leshuar nga Organet e Miratuara te Vlerësimit të Konformitetit (OMVK), dhe Police sigurimi ne nje nga shoqerite e sigurimeve qe operojne ne Shqiperi, per distributoret e shitje me pakice, te cilat duhet te

jene brenda afatit të vlefshmerise daten e hapjes se ofertave, Projekt Teknologjik te miratuar nga organet perkatese te licensuara. Kalibrimi Depozitash leshuar nga DPM.

Ky kriter konsiderohet i permbushur me paraqitjen e formularit te vetdeklarimit sipas shtojces 8. Shënim: Autoriteti Kontraktor do te beje verifikimin e dokumentacionit ne perputhje me vetedeklarimin e bere gjate fazes se ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit te dorezuar perben kusht s'kualifikimi. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të paraqesi dokumentacionin provues, original ose te noterizuar sipas deklarates së mesipërme përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit , brenda afatit nga dërgimi i njoftimi për paraqitjen e tyre.

**Argumentim :** Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" si dhe bazuar ne Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.561 date 29.07.2016 "Per standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve te karburantit ne njesite e qeverisjes se pergjithshme"

Ky kriter është i nevojshëm dhe i arsyeshëm për autoritetin kontraktor, duke përmbushur nevojat e saj në mënyrë të leverdisshme për Bashkinë Polican . Njësia e prokurimit e ka lënë të hapur plotësimin e këtij kriteri për operatorët ekonomik ofertues, duke vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil.

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Operatori ekonomik ofertues duhet te ketë ISO 9001: 2015, ( per të vertetuar që operatori i plotëson kërkesat për sistemin e menaxhimit te cilësise) leshuar nga institucionet e akredituara për këtë qëllim, e cila të perfshijë objektin e prokurimit si dhe të jetë e vlefshme.

- Operatori ekonomik ofertues duhet te ketë ISO 14001:2015,(për te vertetuar që operatori plotëson kërkesat për sistemimin e menaxhimit të mjedisit) leshuar nga institucionet e akredituara për këtë qëllim, e cila të perfshijë objektin e prokurimit si dhe të jetë e vlefshme.

*Argumentimi:* Kërkesa e mesipërme është bazuar në nenin 79, "Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor" të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" *Të gjitha certifikatat e mesipërme duhet të jenë të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e*

*Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme sipas zërave të punimeve që do të realizojë.*

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Fletë-Analizë për produktin e kërkuar-Gazoil (Diesel 10 ppm ULSD), sipas standarteve shtetërore në fuqi lëshuar nga organi kompetent, ose nga një laborator shqiptar i certifikuar, ose i huaj (n.q.s është laborator i huaj, duhet e përkthyer në shqip dhe e noterizuar), që vërteton cilësinë e produktit objekt i këtij prokurimi, brenda 1 viti nga data e shpalljes së procedurës.

**\*Shënim:** Ky përcaktim do të jetë i vlefshëm në çdo rubrikë ku janë përcaktuar këto specifikime. Ky kriter konsiderohet i permbushur me paraqitjen e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8. Shënim: Autoriteti Kontraktor do të beje verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetedeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis. Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s'kualifikimi. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të paraqesë dokumentacionin provues, original ose të noterizuar sipas deklaratës së mësipërme përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, brenda afatit nga dërgimi i njoftimit për paraqitjen e tyre.

2.3.5 Subjekti duhet të deklarojë, se merr përsipër furnizimin në stacione të shitjes së karburanteve me pakicë me shërbim 24 orë në çdo stacion furnizimi të tij, me kartë elektronike të personalizuar me targën e çdo automjeti të AK *ose* Operatori ekonomik duhet të disponojë në pronësi me qera, ose kontrate bashkepunimi minimumi 1 mjete (autobot) me kapacitet mbajtës deri në 1000 l. Lista e automjeteve, Tipi dhe Targa e secilit automjet do të jete pjese e kontrates së fituesit, me AK

Subjekti duhet të deklarojë se merr merr përsipër që të konvertojë të gjithë sasine e litrave të ndodhura në kartën elektronike të personalizuar me targën e mjetit, në leng me bot, deri në perfundimin e plote të kontratës, sipas nevojave të AK.

Për të vërtetuar disponimin e mjeteve të kërkuara më lart operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

**a)** *Për këto mjete që shënohen në regjistra publikë në rastin e pronësisë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (të vlefshme), pasaportën e autobotit, certifikatën e mbrojtjes nga zjarri dhe certifikatën e verifikimit të kotalitrit të lëshuar nga DPM dhe për mjetet e siguruar me qera, kontratën e qerasë (të vlefshme) shoqëruar me dokumentin që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (të vlefshme), pasaportën e autobotit, certifikatën e mbrojtjes nga zjarri dhe certifikatën e verifikimit të kotalitrit të lëshuar nga DPM.*

**Shënim:** Për pikat e mësipërme operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.8.

Në rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose të kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Shënim:** Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te dorezojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Subjekti duhet te deklarojë Se merr përsiper furnizimin me karburant, detyrimisht me pistolete publike.

Bazuar në VKM-në nr. 561 datë 29.07.2016 "Për standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njesitë e qeverisjes së përgjithshme" Operatorët Ekonomik pjesmarrës duhet të ofrojnë një faqe menaxhimi (Webpage) ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit për mjetet efektive të transportit të kryeht nëpërmjet kartës elektronike.

Operatori Ekonomik duhet te ofroje furnizimin me karburant me karte elektronike, e cila duhet të jenë pa skadencë dhe të jetë e përdorshme gjatë vitit 2024-2025 ne përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 561 datë 29.07.2016 "Per Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njesitë e qeverisjes së përgjithshme".

**Argumentim :** Keto kriter u vendos në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" si dhe bazuar ne Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.561 date 29.07.2016 "Per standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve te karburantit ne njesite e qeverisjes se pergjithshme" dhe jane te nevojshëm dhe te arsyeshëm për autoritetin kontraktor, duke përmbushur nevojat sipas standarteve ne fuqi si dhe në mënyrë të leverdisshme për Bashkinë Polican .

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**Anetaret e njesise se Prokurimit**